



Funded by
the European Union



THIRRJE PËR APLIKIM

EKSPERTIZË NË FUSHËN E NDËRMJETËSIMIT

Projekti: “Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri”.

Qëllimi: Përgatitja dhe shpërndarja e udhëzuesve për ndërmjetës aktivë të licensuar.

Vendndodhja: Tiranë.

Numri ekspertëve: 2 (dy) ekspertë në total. Një ndërmjetës dhe një Psikolog.

Raportimi tek: CSSP- Berlin Center for Integrative Mediation.

Afati i fundit për aplikime: 22.10.2024 - 18:00 CET.

Periudha e shërbimit: 1 Nëntor 2024 – 10 Dhjetor 2024.

KUSH JEMI NE

CSSP — Berlin Center for Integrative Mediation është një organizatë jofitimprurëse me seli në Berlin, Gjermani dhe me zyra vendore në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri. Kjo organizatë ka vepruar dhe në vende të tjera si Azi, Evropë dhe Afrika e Veriut. CSSP është e pranishme në Shqipëri që nga viti 2018 për të zbatuar projektet më të rëndësishme në Sistemin e Ndërmjetësimit, në bashkëpunim me partnerë të rëndësishëm.

Që nga shkurti 2024, CSSP po zbaton projektin “*Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri*” i financuar nga Bashkimi Evropian, në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI) dhe në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve (DHKN) dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas nën Ministrinë e Drejtësisë. Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin e ndërtimit të kapaciteteve të ndërmjetësve, të mbështesë trajnimet e DHKN-së, të promovojë përdorimin e ndërmjetësimit te aktorë të ndryshëm dhe të forcojë kapacitetet e ofruesve të ndihmës juridike falas për referimin e rasteve në ndërmjetësim. Kjo thirrje për aplikim është pjesë e projektit të sipër përmendur.

Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve është një Ent Publik Juridik i pavarur, e cila ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr. 10385 datë 24.2.2011, i ndryshuar. DHKN rregullon dhe kontrollon ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit. DHKN ofron trajnime vazhduese për ndërmjetësit dhe organizon trajnime fillestare me kandidatët për ndërmjetës, midis aktiviteteve të tjera.

Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI) është një organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare shqiptare, e cila aktualisht është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë për të ofruar ndihmë juridike parësore falas. Që nga viti 2004, QSHPLI ka punuar për ofrimin e asistencës ligjore dhe psikologjike falas për grupet vulnerabël dhe zbatimin e drejtësisë restauruese për të miturit në Shqipëri.



Funded by
the European Union



OBJEKTI SHËRBIMIT

CSSP po kërkon të kontrakttojë dy ekspertë për një angazhim afatshkurtër nga 1 nëntori 2024 deri më 10 dhjetor 2024: një ndërmjetës dhe një psikolog. Atyre do t'u kërkohej të hartojnë dy udhëzues të detajuar për ndërmjetësit e licencuar në kuadër të aktivitetit të projektit: “Përgatitja dhe shpërndarja e udhëzuesve për ndërmjetës aktivë të licencuar”.

Përshkrimi aktivitetit

Ky aktivitet synon zhvillimin e kapaciteteve të ndërmjetësve aktivë të licencuar për ndërmjetësimin, për të përmirësuar cilësinë e shërbimit të ndërmjetësimit që ofrohet për qytetarët. Rritja e cilësisë së shërbimeve të ndërmjetësimit është çelësi për të gjeneruar besim dhe për të rritur përdorimin e ndërmjetësimit në Shqipëri. Në këtë kontekst, ofrimi i disa udhëzuesve të thjeshtë është i nevojshëm, në mënyrë që të gjenerohen mesazhe të njëtrajtshme për përdorimin e ndërmjetësimit dhe harmonizimin e praktikave midis ndërmjetësve. Këto udhëzues do të jenë gjithashtu të dobishëm për profesionet e tjera ligjore që ofrojnë shërbime në çështjet familjare dhe penale.

Dy ekspertët (një ndërmjetës dhe një psikolog) do të bashkëpunojnë në hartimin e dy udhëzuesve, duke ofruar ekspertizën e tyre përkatëse. Ndërmjetësit dhe psikologët konsiderohen profesionistë kryesorë në rastet e ndërmjetësimit, kur përfshihen veçanërisht të miturit, qoftë në çështjet penale apo ato familjare. Çdo ekspert do të duhet të angazhohet 20 ditë pune për hartimin dhe dorëzimin përfundimtar të dy udhëzuesve.

➤ Udhëzues për rastet e ndërmjetësimit në çështjet penale.

Objektivi kryesor i këtij udhëzuesi është të sigurojë një material të qartë dhe praktik për ndërmjetësit aktivë në temat e mëposhtme në veçanti, në kontekstin e çështjeve penale ku përfshihen të rriturit, dhe në rastet penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe viktimat.

Eksperti ndërmjetës do të fokusohet veçanërisht në informacionin dhe orientimin e palëve në ndërmjetësim, procesin e ndërmjetësimit, pasojat ligjore të një marrëveshjeje ndërmjetësimi, zhvillimin e modeleve për hapat e procesit të ndërmjetësimit.

Eksperti psikolog do të fokusohet veçanërisht në rolin e mundshëm që mund të ketë një psikolog në çështjet penale që zgjidhen me ndërmjetësim, koordinimin me ndërmjetësin dhe aktorët e tjerë në faza të ndryshme. Gjithashtu, ai/ajo do të duhet të qartësojë shërbimet që psikologu ofron në këtë kuadër për të rinjtë në konflikt dhe në kontakt me ligjin.

➤ Udhëzues për rastet e ndërmjetësimit në çështjet familjare.

Objektivi kryesor i këtij udhëzuesi është të sigurojë një material të qartë dhe praktik për ndërmjetësit aktivë në rastet familjare.

Eksperti ndërmjetës do të fokusohet veçanërisht në informacionin dhe orientimin e palëve në ndërmjetësim, procesin e ndërmjetësimit, pasojat ligjore të një marrëveshjeje ndërmjetësimi, zhvillimin e modeleve për hapat e procesit të ndërmjetësimit, në rastet familjare.

Eksperti psikolog do të shpjegojë rolin e psikologut në faza të ndryshme të procesit, si dhe ndërlidhjen me ndërmjetësin dhe aktorët e tjerë brenda sistemit të drejtësisë. Ai/ajo do të tregojë shërbimet që psikologët ofrojnë edhe për familjen.



Funded by
the European Union



Ekspertiza përfshin shërbimet e mëposhtme:

- Pjesëmarrje në të paktën 3 takime koordinuese në zyrë dhe/ose në distancë.
- Dorëzimin e draftit të parë të dy udhëzuesve në rastet e ndërmjetësimit penal dhe familjar.
- Dorëzimin e draftit përfundimtar të udhëzuesve në rastet e ndërmjetësimit penal dhe familjar.
- Kryerja e një pre dhe post testi për të vlerësuar njohuritë e ndërmjetësve të licencuar në çështjet familjare dhe penale.
- Dorëzimi një raporti përfundimtar mbi detyrën (maksimumi 1 faqe).

KRITERET E PRANIMIT DHE PROCESI I PËRZGJEDHJES

Çdo aplikant në këtë thirrje do të përjashtohet automatikisht nëse ai/ajo ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

- Ai/ajo nuk ka një reputacion të mirë në profesionin e tij/saj dhe/ose në rast se ka kryer ndonjë shkelje administrative ose ka ndonjë masë disiplinore në fuqi.
- Aktualisht është i punësuar në administratë publike.
- Dokumentet e kërkuara në aplikim dhe/ose oferta financiare mungojnë.
- Në rast se numri regjistrimit të aktivitetit (NIPT) nuk është aktiv ose është i pezulluar.

❖ Kriteret profesionale për NDËRMJETËS

Kërkojmë të kontraktojmë **1 Ndërmjetës**, që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Të ketë diplomë në fushën juridike dhe master (**15 pikë**).
- Të jetë ndërmjetës i licencuar prej të paktën 5 vitesh (**15 pikë**).
- Përvojë e qëndrueshme profesionale në punën me të mitur në çështjet familjare dhe penale (**10 pikë**).
- Përvoja të mëparshme pune në hartimin e kurrikulave dhe/ose ofrimin e trajnimeve, hartimin e protokolleve të punës etj. për profesionistët e drejtësisë në tema që lidhen me legjislacionin dhe/ose ndërmjetësimin e drejtësisë për të miturit; (**10 pikë**).

Kriteri ekonomik

- Oferta financiare vlerësohet (30 pikë). Oferta financiare duhet të tregojë ditët e punës dhe çmimin për një ditë pune, duke specifikuar vlerën e TVSH-së, nëse ka.

❖ Kriteret profesionale për PSIKOLOG

Kërkojmë të kontraktojmë **1 Psikolog**, që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Përvojë e qëndrueshme profesionale si psikolog, të paktën prej 10 vitesh (**15 pikë**).
- Përvojë profesionale si psikolog ligjor për të mitur në gjykata/prokurori dhe institucione të tjera të drejtësisë (**15 pikë**).
- Të ketë certifikata të trajnimit në psikologjinë ligjore (**10 pikë**).
- Përvoja të mëparshme pune si në hartimin e protokolleve të punës, udhëzimeve, manualeve, broshurave etj., për profesionistët e drejtësisë në tema që lidhen me legjislacionin e drejtësisë për të miturit dhe/ose çështjet familjare (**10 pikë**).

Njoftim përgjegjësie: Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e CSSP dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.



Funded by
the European Union



Kriteri ekonomik

- Oferta financiare vlerësohet (30 pikë). Oferta financiare duhet të tregojë ditët e punës dhe çmimin për një ditë pune, duke specifikuar vlerën e TVSH-së, nëse ka.

Ne inkurajojmë shumë aplikimin e grave dhe profileve të ndryshme.

Procesi i vlerësimit

Të gjitha aplikimet e dorëzuara do të vlerësohen sipas kriterëve të përshtatshmërisë të përshkruara në këtë thirrje. Aplikantët që do të arrijnë më pak se 50 pikë do të skualifikohen automatikisht. Kandidatët mund të ftohen për intervistë.

SI TË APLIKONI

Ju lutem dërgoni aplikimin tuaj në gjuhën angleze ose shqipe dhe në formatin PDF në CSSP- Berlin Center for Integrative Mediation, email: albania@cssp-mediation.org jo më vonë se data **22/10/2024**. Aplikimi duhet të përfshijë:

- a) Një letër interesi, e cila duhet të tregojë ekspertizën specifike që doni të mbuloni (ndërmjetës/psikolog). Kandidatët duhet të japin edhe të dhëna lidhur me kriteret profesionale të lartpërmendura.
- b) Një CV që përshkruan fushën tuaj specifike të ekspertizës.
- c) Deklaratë individuale për moskonflikt interesi me këtë pozicion shërbimi, ku deklarohet edhe mungesa e ndonjë mase administrative ose disiplinore nga kandidati.
- d) Një ofertë financiare që tregon vlerën për njësi ditore, në valutën EURO, duke specifikuar vlerën e TVSH-së, nëse ka.
- e) Një kopje të numrit të regjistrimit tatimor (NIPT).

Shënim: Dokumentet e aplikimit sipas pikave a), c) dhe d) duhet të dorëzohen të nënshkruara dhe të skanuara.

Shumë faleminderit për interesimin tuaj dhe kohën e investuar në aplikimin tuaj.

Tiranë me 14/10/2024